



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:300994

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05631155

P.nr.3993/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Dibran Jusufi, me bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.L., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë me numër PP.II.nr.7323/2023, të datës 28.12.2023, pas mbajtjes së seancës dëgjimore lidhur me pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Nebahate Salihu, i akuzuari I.L. si dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av. Hajzer Salihu, me datë 23.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 29.04.2024 përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari I.L. nga babai R., nëna Sh., e gjinisë B., i lindur me datë, në, me vendbanim në fshatin, në rrugën “.....”, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i papunësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal të letërnjoftimit

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 19.07.2023, rreth orës 23:40, në rrugën “Ramiz Cernica” në Prishtinë, me dashje dhe vetëdije e në kundërshtim me nenin 3 pika 1.7 lidhur me nenin 4 par.1 pika 1.4.4 të ligjit për Armët, pa autorizim në vende publike posedon armë të shkurtë të tipit TT 7.62mm me numër serik, 5 copë fishek cal 6.5mm dhe 2 copë fishek cal 7.62mm , në atë mënyrë që ditën kritike njësia policore gjatë një pike kontrollë kanë ndaluar veturën e tipit Audi A6, ku gjatë kontrollës i është gjetur arma dhe karikatori, të cilat më pas i konfiskohen nga policia e Kosovës,

-Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-ës,

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe 79 të KPRK-ës dhe neneve 230 e 364 të KPP-ës të akuzuarin e lartcekur:

E GJYKON

I. Me dënim me gjobë në shumë prej 700 € (shtatëqind euro), i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.

II. Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

III. Në bazë të nenit 366 paragrafi 3 i KPRK-ës nga i akuzuari konfiskohet arma (revole) e shkurtër e tipit TT 7.62mm me numër serik, 1 karikator me numër serik 2661, 5 copë fishek cal 6.5mm dhe 2 copë fishek cal 7.62mm, të sekuestruara nga Policia me vendimin për sekuestrim me numër 2023-AD-2606 të datës 20.07.2023 të cilat duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me institucionet tjera relevante, sipas procedurave standarde në fuqi.

IV. Obligohet i akuzuari i lartcekur që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € (tridhjetë euro) si dhe shumën prej 20 € (njëzetë euro) për fondin për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

-Rrjedha e procedurës penale dhe vlerësimi i marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë-

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm me datë 28.12.2023 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.7323/2023 kundër të pandehurit I.L. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-ës.

Me datë 20.03.2024, Prokuroria Themelore në Prishtinë pranë kësaj gjykate ka dorëzuar Marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të arritur në mes të të akuzuarit I.L. me mbrojtësin e tij në

njërën anë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë në anën tjetër. Me datë 23.04.2024 pranë kësaj gjykate është caktuar dhe mbajtur seanca dëgjimore lidhur me pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Nebahate Salihu, i akuzuari I.L. dhe mbrojtësi i tij. Në këtë seancë është shqyrtuar marrëveshja mbi pranimin e fajësisë me ç ‘rast pas dëgjimit të palëve gjykata ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar marrëveshjen e lartcekur ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 230 paragrafi 17 dhe 18 të KPP-ës, në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë e arritur ndërmjet prokurorit të shtetit në njërën anë si dhe të akuzuarit me mbrojtësin e tij në anën tjetër i përmbush të gjitha kushtet ligjore si dhe e njëjta është arritur në bazë të nenit 230 të KPP-ës, po ashtu me rastin e pranimin të kësaj marrëveshje gjykata ka konstatuar edhe faktin se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe prova materiale të cilat i përmban aktakuza, e po ashtu gjykata në këtë çështje penalo juridike gjeti se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara nga neni 248 paragrafi 1 të KPP-ës.

-Gjendja faktike e vërtetuar-

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-ës, dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të kësaj vepre penale.

-Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit-

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit duhet ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata ka marrë për bazë edhe rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK, ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marrë faktin se i njëjti ka arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë përkatësisht ka pranuar fajësinë në një fazë të hershme të procedurës penale, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e veta si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të

përsërisë veprime të tilla, karakteristikat e tij personale ngase i njëjti nuk kishte rënë më parë ndesh me ligjin përkatësisht nuk kishte qenë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata mori rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata të akuzuarit i shqiptoj dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj tij mund të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

-Vendimi lidhur me konfiskim-

Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 276 par. 1 dhe 2 të KPP-së, si dhe në bazë të nenit 366 paragrafi 3 i KPRK-ës nga i akuzuari konfiskohet arma (revole) e shkurtër e tipit TT 7.62mm me numër serik, 1 karikator me numër serik 2661, 5 copë fishek cal 6.5mm dhe 2 copë fishek cal 7.62mm, të sekuestruara nga Policia me vendimin për sekuestrim me numër 2023-AD-2606 të datës 20.07.2023 të cilat duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me institucionet tjera relevante, sipas procedurave standarde në fuqi. Gjykata, ka vërtetuar se i pandehuri nuk posedonte leje, e as autorizim për posedimin e armëve, për më tepër, arma e lartcekur bënë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike, andaj gjykata ka vendosur të konfiskoj përherë këto armë, si dhe ka urdhëruar shkatërrimin e tyre, pasi që ekziston baza ligjore për konfiskimin e përhershëm të armëve, ashtu siç përcaktohet me nenin 276 të KPP-së dhe nenin 366 par.3 të KPRK-së, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm.

-Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale-

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së. Ndërsa, për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr komfor nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.3993/23 me datë 29.04.2024

Numri i lëndës: 2023:300994
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05631155

Gjyqtari i vetëm gjykues
Dibran Jusufi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Prishtinë.